



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:105889

Datë: 13.08.2024

Numri i dokumentit: 06043741

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit Xh.H. me vendbanim në rrugën “...” nr. ..., komuna Shtime, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.998/2020 të datës 31.08.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, më datë 10.06.2024, në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha palët dhe atë prokurori i shtetit Dardan Çela, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri Xh.H., me mbrojtësin e tij me autorizim av. Kemajl Ademaj dhe përfaqësuesen me autorizim të palës së dëmtuar T.K., më datë 05.08.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 13.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

XH.H., nga i ati G. dhe ëma T., e gjinisë K., i lindur me ..., në Shtime, me vendbanim në rrugën “...” nr. ..., komuna Shtime, me vendqëndrim në shtetin e Sllovenisë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 362 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. të KPP-së, për shkak të heqjes dore nga akuza nga ana e prokurorit të shtetit:

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Prej datës së pavërtetuar e deri me datë 13.03.2020, në lokalin e tij pastiqeria “D.”, i cili gjendet në Rr. “...”, në Shtime, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetit ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme ka siguruar shërbime për të cilat e ka ditur se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe ka shmangur pagesën për shërbime të tilla, duke përdorur energjinë elektrike pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që personat e autorizuar të KEDS-it, gjatë kontrollës së njehsorit elektrik me nr. ... (grupi tarifor ../02), kanë hasur në keqpërdorim, ku i pandehuri kishte bërë një lidhje tjetër jashtë njehsorit të rregullt, ashtu që ajo lidhje shkon përmes një njehsori tjetër i cili teknikisht nuk është i lidhur në mënyrë të rregullt dhe nuk bën matjen e energjisë elektrike dhe si rrjedhojë e kësaj energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare në njehsor elektrik, me ç’rast të dëmtuarës KEDS – distrikti në Ferizaj i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 6248.79 euro.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale **Vjedhja e shërbimeve** nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

- E dëmtuara Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë SH.A. (KEDS) – distrikti Ferizaj, nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.
- Shpenzimet e procedurës penale për këtë çështje juridiko-penale mbeten në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.998/2020 të datës 31.08.2020, ndaj të pandehurit Xh.H. me vendbanim në rrugën “...” nr. ..., komuna Shtime, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor ku janë administruar provat si në vijim:

Dëshmia e dëshmitarit Agron Abdullahu e dhënë në shqyrtim gjyqësor, Dëshmia e dëshmitarit Bajram Fejzullahu e dhënë në shqyrtim gjyqësor, Dëshmia e dëshmitarit Xh.Xh. e dhënë në shqyrtim gjyqësor, Dëshmia e dëshmitarit M.M. e dhënë në shqyrtim gjyqësor si dhe provat materiale Procesverbali me numër 0...2, i datës 13.03.2020; 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë të formatit A4 me fotografi; Fatura me numër DFEHP...3 e datës 17.03.2020; Rikthimi i humbjeve me numër ... i datës 17.03.2020; 5 (pesë) fletë të formatit A4, me të dhënat lidhur me hyrjet – daljet të pandehurit në Republikën e Kosovës dhe shteteve të tjera. Shkresa me titull transaksionet e konsumatorit – ekstrakt nga librat afarist e lëshuar nga KEDS në emër të Xhe.G.H. si dhe shkresa me të dhënat lidhur me biznesin individual M.M.

I pandehuri Xh.H. e ka dhënë mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: në kuptim të nenit 51 të KPP-së, prokurori i shtetit tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të pandehurit Xh.H. për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Neni 51 i KPP-së përcakton se: *“Prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga ndjekja deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor para gjykatës themelore, kurse në procedurat para gjykatës më të lartë, ai mund të tërhiqet nga ndjekja vetëm në rastet e parapara me këtë Kod”*. Andaj, tërheqja nga ndjekja penale lejohet edhe në fjalën përfundimtare dhe si e tillë është në përputhje të plotë me këtë dispozitë ligjore.

Neni 362 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. i KPP-së përcakton se *“Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur: 1.1 prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor”*. Gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Neni 459 paragrafi 4 i KPP-së përcakton se: *“Kur personi i autorizuar nuk e ka paraqitur propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale para ngritjes së aktakuzës, ai duhet njoftuar se propozimin mund ta paraqesë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Kur me vepër penale është shkaktuar dëm në pasurinë në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore dhe nuk është paraqitur propozim, gjykata për këtë e njofton organin ose personin kompetent sipas nenit 458, paragrafi 2 i këtij Kodi. Pala informohet se mosparaqitja e propozimit mund ta përjashtojë palën e dëmtuar nga Programi i Kompensimit të Viktimave*

edhe nëse pala do të plotësonte kriteret tjera të pranueshmërisë sipas ligjit në fuqi". Andaj, gjykata e ka njoftuar përfaqësuesen e palës së dëmtuar për këtë të drejtë, mirëpo e njëjta ka deklaruar se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike sa i përket të pandehurit Xh.H. .

Neni 452 paragrafi 1 i KPP-së përcakton se: *“Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni.”* Andaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore vendosi që shpenzimet e procedurës penale për këtë çështje juridiko-penale mbeten në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2020:105889, me datë 13.08.2024

Zyrtarja ligjor,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj. Të gjitha palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.